



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha**

Elbasan, më __.06.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Hipoklorit Natriumi

Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): klor 24312200-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 6000000 (Gjashte milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria **UK Rajoni Elbasan**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas Shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise se shoqerise (QKB) mallin objekt prokurimi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43 dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Ofertuesi duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat që garantojnë cilësinë:

a-Çertifikatën e Cilesise: ISO-9001 për Sistemet e Menaxhimit të Cilesise (të vlefshme për periudhë tenderit dhe të perkthyer në shqip), ose një Çertifikatë ekuivalente me të. Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga institucione të akredituara ndërkombëtare, objekt i të cilit është të jete në përputhje me objektin e prokurimit, të akredituar nga institucionet shtetërore vendase ose të huaja, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, nëse i disponojnë certifikatën të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit komformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit/organizma ndërkombëtare akreditue njohur nga RSH. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO-9001, ose ekuivalente me të.

b-Çertifikatën e Cilesise: OHSAS-18001 për Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (të vlefshme për periudhën e tenderit dhe të perkthyer në shqip) ose një Çertifikatë ekuivalente me të. Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga institucione të akredituara ndërkombëtare. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën OHSAS-18001, ose ekuivalente me të, ose certifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në proporcion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Certifikata e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001, është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet natyrën dhe vlerën e

kontrates, me qëllim për të vertetuar dhe të garantojë realizimin në kohë sukses dhe me cilësi. Kërkesa në lidhje me këtë certifikatë është në përputhje me nenin 44, të V Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe nenin 79 të L Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

2.3.3 Ofertuesi duhet të vertetojë se produkti që do të furnizohet është i pershtatshëm në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njërezor, konform normave europiane: EN 901:2013. Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues (Certifikatë) dokumentacion nga prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të akredituara nga institucionet perkatese, që deshmon që produkti i prodhuar plotëson Standartin Europian të kerkuar EN 901:2013" ose ekuivalente me të dokument që plotëson standartin shqiptar S SH/EN 901:2013 mbi parametrat e Hipokloritit të Natriumit.

Ofertuesi duhet të paraqesi certifikatën e analizës së lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik për ato parametra të cilët analizohen nga ky institucion si laborator reference për analizë toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi).

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që ti shërbejnë AK-se, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në përmbushje të kriterit të mesipër, Operatorët Ekonomikë, duhet të paraqesin dëshmi që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kerkuara. Është në të drejtën e AK të kërkojë fletë analize që vertetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të vendosura, përpara se AK të bejë përzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kërkesë është në përputhje me piken 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.3.4 Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për artikujt objekt prokurimi për lejim tregtimi të mallrave në RSH kjo të vertetuar me dokumenta origjinale si përfaqësues dhe i autorizuar i kompanisë prodhuese për të gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi.

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e origjinës cilësive dhe skedë sigurie për hipoklorit natriumi lëshuar nga prodhuesi (e perkthyer dhe noterizuar në shqip). Në rast paraqitje autorizimi distributori ofertuesi duhet të paraqesë autorizimin ose marrëveshjen midis prodhuesit dhe distributorit të vlefshme. Autorizimi të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit (email tel etj) kjo të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a -një certifikatë **Nr.Reach** të prodhuesiti cili vërteton se prodhuesi/t është/janë të regjistruar dhe të çertifikuar për tregtimin e hipokloritit të natriumit dhe hipokloritit të kalciumit për trajtimin e ujit për konsum njerëzor në komunitetin Europian.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Qëllimi i Reach është përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit përmes identifikimit të mirë dhe të hershëm të vetive të brëndëshme të substancave kimike. Rregullorja REACH i jep përgjegjësi më të madhe industrisë për të menaxhuar rreziqet nga kimikatet dhe për të siguruar informacion të sigurisë

Çdo prodhues ose importues i hipokloritit të natriumit duhet të jetë i regjistruar për të lejuar tregtimin në tregun europian.

Regjistrimi REACH garanton që substancat janë vlerësuar për rreziqet ndaj shëndetit dhe mjedisit, duke minimizuar ndikimet negative në ujë e destinuar për konsum njerëzor.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Duhet të ketë në pronësi ose me qera

- a) **2 (dy)** mjete të autorizuar tip autobot **ose** kamion , për transport kimikatesh (hipokloritin e natriumit dhe Hipoklorit kalciumit) , ku te paktën 1 (një) të jetë me kapacitet mbajtës 12-14 ton dhe 1 (një) me kapacitet mbajtës 15-25 ton, që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet:

- a) dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit
- b) leje qarkullimi për “Transport lëndë të rrezikshme”,
- c) lejen e qarkullimit,
- d) certifikatën e kontrollit teknik,

- e) siguracionin e mjetit (të vlefshme),
- f) certificate konformiteti e cisternës rrugore dhe certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.
- g) Certifikatë për transport mallërash për të tretë dhe me qera brënda vëndit
- h) foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe target e mjetit.

Gjithashtu dhe për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet:

- a) Kontrata e qerase ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij
- c) lejen e qarkullimit,
- d) certifikatën e kontrollit teknik,
- e) siguracionin e mjetit (të vlefshme),
- f) certificate konformiteti e cisternës rrugore dhe certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.
- g) Certifikatë për transport mallërash për të tretë dhe me qera brënda vëndit
- h) foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe target e mjetit.

Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- a) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publik duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në cdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet dhe paisjet teknike të deklaruar.

Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me Ligjin Nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” si dhe me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”.

Ky është një kriter jo vetëm i nevojshëm por i domosdoshëm, pasi klori i lengshëm duhet të sillët nga operatori ekonomik sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor direkt në stacionet e pompimit të ujit të pijshëm. Kjo sasi hipoklorit natriumi mujor me mjet transporti do të duhet të garantojë Autoritetin Kontraktorë për disponueshmërinë e mallit objekt prokurimi i cili është garant për furnizimin mujor me hipoklorit natriumi, sipas grafikut të levrimit, frekuences mujore të furnizimit

dhe sipas nevojave per cilesinë e ujit të pijshëm e per rrjellojë garantimin e shendetit dhe jetes së konsumatorëve. Prandaj është e domosdoshme dhe e qartë që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjet transporti sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor për këtë qëllim, në pronësi ose ta sigurojë atë nepermjet kontratës së qirasë për ta kryer shërbimin në kohë, sasi dhe cilësi sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sh.a për klorifikimin e ujit të pijshëm gjatë gjithë periudhes se ezaurimit te kontrates.

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar ne skedat teknike te pajisjeve dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Njesia e Prokurimit
